



PËRMBAJTJA

- Aktivitetet e UBSHGJ 2
- Statistika/Kosovë 6
- Statistika/Gjermani 11
- Arsyet për të investuar në Kosovë 13
- Profili i anëtarëve 14

*“Nëse nuk mund të fluturosh,
vrapo. Nëse nuk mund të
vraposh, ec. Nëse nuk mund të
ecësh, zvarritu. Por çfarëdo që të
bësh, duhet të vazhdosh të
lëvizësh përpara.”*

Martin Luther King Jr.



AKTIVITETET E UBSHGJ

Unioni në "Diaspora flet"

I ftuar nga Germin, UBSHGJ mori pjesë në ditën e dytë të konferencës "Diaspora Flet". Në panelin për diskutim, me temën Diaspora për Zhvillim: Teknologjia, Sipërmarrësia dhe Investimet Kapitale, Unioni u përfaqësua nga Fadil Abdullahu, Drejtori Ekzekutiv.



Ai foli rreth potencialit të madh të diasporës shqiptare në Gjermani, ku tashmë shumë biznese shqiptare janë faktorë të rëndësishëm në fushën e investimeve. Po ashtu, shprehu para të pranishmëve gatishmërinë e Unionit për vazhdimin dhe forcimin e rolit të tij në bashkëpunimin midis bizneseve nga Gjermania dhe Kosova.

Në panairin, që u zhvillua në kuadër të këtij organizimi, aktivitetin e tij e prezantoi edhe UBSHGJ. Shtandin e Unionit e vizitoi edhe kryeministri i Kosovës,

Albin Kurti, me ç'rast edhe u njoftua me aktivitetet tona dhe për hapjen e zyrës sonë në Prishtinë.

UBSHGJ organizon takime B2B me prodhuesit dhe përpunuesit e drurit nga kosova



Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane, në bashkëpunim me Shoqatën e Përpunueseve të Drurit të Kosovës (SHDPK), Agjencinë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), USAID Kosovo Compete Activity dhe Caritas - zyra në Kosovë, organizuan në Këln të Gjermanisë aktivitetin B2B dhe panairin "KOSOVA DAY". Pjesë e këtyre aktiviteteve ishin përfaqësuesit e shumë kompanive nga Gjermania dhe Kosova.

Në emër të UBSHGJ, të pranishmit i përshëndeti nënkryetari Zenun Krasniqi. Duke i falënderuar për bashkëpunimin, ai i siguroi ata që UBSHGJ do të vazhdojë të bëjë promovimin e bizneseve nga Kosova dhe të luaj rol in e lehtësuesit të bashkëpunimit midis kompanive që veprojnë në Gjermani dhe atyre nga vendlindja.

Përfaqësuesit e UBSHGJ, Shkëndije Pacolli (anëtare e kryesisë), Fadil Abdullahu (Drejtör Ekzekutiv) dhe Ukë Blakaj (Kryetar i degës së UBSHGJ në Frankfurt), vizituan të gjitha shtandet e kompanive anëtare të saj e po ashtu kompanitë pjesëmarrëse nga Kosova.



Zhvillohet aktiviteti “Diaspora për Gratë Ndërmarrëse”



USAID Compete Activity, GERMIN dhe Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane organizuan tryezën e përbashkët me temën “Gratë në Biznes”. Pjesë e këtij takimi të mbajtur në Dyseldorf, ishin 21 gra ndërmarrëse nga Kosova e po ashtu gra nga fusha e biznesit në Gjermani.

Në këtë tryezë u diskutuan qëllimet, sukseset dhe sfidat e grave në biznes. Gjatë këmbimit të përvojave dhe njohurive, gratë nga Kosova rrëfyan historitë e tyre të suksesit. Në anën tjetër, gratë nga diaspora, ndanë me të pranishmit rrëfimet e tyre për rrugën dhe sfidat me të cilat janë përballur për t'i arritur sukseset që i gëzojnë.

Në kuadër të këtij aktiviteti u organizuan edhe takime B2B në mes të bizneseve nga Kosova dhe atyre nga Gjermania, ku interesim i veçantë iu kushtua pozicionimit të produkteve nga Kosova në tregun gjerman. Të pranishmet i përshëndeti edhe Kryetari i UB, z. Nazmi Viqa, i cili tregoi se interesimi i kyçjes së gruas shqiptare në UB po rritet çdo ditë e më shumë.

Ky aktivitet u përcoll edhe me një vizitë të pjesëmarrëseve në kompaninë prodhuese në Gjermani “Rexhi”, anëtare e UBSHGJ. Qëllimi i vizitës ishte që gratë ndërmarrëse nga Kosova të njihen me procesin e prodhimit, kualitetin, certifikimin dhe plasimin e produkteve në tregun gjerman. Kjo, pasi që kompania “Rexhi”, është e njohur për cilësinë e produkteve të saj, gjë që i ka mundësuar asaj bashkëpunimin me korporatat me renome si: Deutsche Bahn, Siemens, DHL, Alstom etj.





Trajnimi i dytë nga fusha e ndërtimtarisë, patundshmërive dhe të drejtës, si dhe mbrojtja në punë

UBSHGJ organizoi trajnimin e dytë, nga fusha e ndërtimtarisë, patundshmërive dhe të drejtës për mbrojtje në punë. Trajnimi u mbajt në Frankfurt dhe ishte rezultat i bashkëpunimit në mes të zyrës lidere në fushën e të drejtës ekonomike, Oppenhoff dhe UBSHGJ. Me këtë rast u trajtuan disa prej çështjeve të ndjeshme që lidhen me projektet ndërtimore, si: mënyra e kalkulimit të ofertës dhe sigurimi i saj juridik në kontratë, mbrojtja në punë, sigurimi i punishteve, sigurimi në proceset e falimentimit etj. Kësaj radhe, pjesë e këtij trajnimi ishin kompani anëtare të UBSHGJ, nga rrethina e Frankfurtit dhe Shtutgartit.



20 biznese nga Saarland bëhen pjesë e UBSHGJ

Kryetari i Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane, Nazmi Viqa, së bashku me anëtarët e kryesisë, takuan përfaqësuesit e disa bizneseve në Saarbrücken.

Qëllimi i këtij takimi ishte njoftimi i këtyre bizneseve me vizionin, qëllimin dhe aktivitetet e UBSHGJ, si dhe zgjerimi i tij me anëtarë të rinj.

Kryetari Viqa nënvizoi rëndësinë e angazhimit të përbashkët të kompanive që veprojnë në Gjermani për krijimin e raporteve bashkëpunuese midis vete dhe koordinimin për realizimin e investimeve të përbashkëta.

Nënkryetari i degës së UBSHGJ në Frankfurt, ku bënë pjesë edhe kjo Republikë, Irfan Tërnavë, pasi falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, i njoftoi ata për organizimin e bizneseve shqiptare në këtë republikë dhe gatishmërinë e tyre për një bashkëpunim me biznese të tjera në Gjermani e më gjerë.

Lidhur me qëllimin, mënyrën e funksionimit dhe aktivitetet e UBSHGJ, përfaqësuesit e bizneseve i informoi drejtori ekzekutiv, Fadil Abdullahu.

Në këtë takim, në të cilin UBSHGJ iu bashkuan 20 biznese, me përkrahje unanime u zgjodhën koordinatorët e UBSHGJ për këtë Republikë. Koordinatorët Ali Durmishi,



Isuf Zogiani, Burim Braina dhe Kujtim Demi, u shprehën mirënjohës për besimin e dhënë dhe u zotuan që do të jenë urë lidhëse e bizneseve të kësaj pjese të Gjermanisë me bizneset në republikat tjera dhe ato të vendlindjes.



TERMI i këtij numri

RECESION /

Nuk ka një definicion zyrtar për termin recesion, por ekziston një pajtim i përgjithshëm që ky term i referohet një periudhe të rënies së aktivitetit ekonomik, ku investimet humbasin vlerën, bizneset dështojnë dhe papunësia rritet (rënia e Bruto Produktit Vendor). Rënia për një periudhë të shkurtër nuk konsiderohet recesion. Për t'u konsideruar e tillë, duhet që ajo të ndodhë për, të paktën, dy tremujorë radhazi. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), ndërmjet viteve 1960 dhe 2007, pati 122 recesione që prekën 21 ekonomi të përparuara.


STATISTIKA / KOSOVË

Indikatorët Makroekonomikë për Kosovë 2018-2022

	2018	2019	2020	2021	2022
BPV (mil.€)	6,671.5	7,056.1	6,771.6	7,957.8	8,954.8
Norma reale e rritjes së BPV (%)	3.4	4.8	-5.3	10.7	3.5%
BPV për koke banori (€)	3,715	3,959	3,772	4,486	/
Eksporti (mil.€)	367.5	383.5	474.8	755.7	920.4
Importi (mil.€)	3,347.0	3,496.9	3,296.6	4,684.1	5,639.3
Indeksi i Harmonizuar i çmimeve të Konsumit (%)	1.1	2.7	0.2	3.4	11.6
Investimet e huaja	272.1	254.6	345.7	420.7	778.2
Remitencat (mil.)	800.6	851.5	980.0	1,153.4	1,222.8
Borxhi Publik (% e BPV)	17.04	17.63	22.44	21.53	20.74

(Burimi: Ministria e Ekonomisë)


Bruto Produkti Vendor 2018-2022



(Burimi: Ministria e Ekonomisë)




Remitencat dhe investimet e jashtme direkte 2018-2022



(Burimi: Ministria e Ekonomisë)

Investimet e jashtme direkte në Kosovë sipas viteve



(Burimi: Banka Qendrore e Kosovës, përmes KIESA)

Investimet e jashtme direkte në Kosovë sipas aktivitetit ekonomik (2022)

Aktiviteti ekonomik	Vlera mil. €
Aktivitete te patundshmërisë	523.7
Aktivitete financiare dhe te sigurimit	53.9
Ndërtimtari	26.7
Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe furnizimi me ajër te kondicionuar	44.9
Xehetaria dhe guroret	52.4
Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	15.1
Prodhim	14.3
Informacion dhe komunikim	14
Te paspecifikuara	12.6
Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	10.7
Aktivitete administrative dhe mbështetëse	10.7
Arsim	2.2
Administrata publike dhe mbrojtje; sigurim social i detyrueshëm	1.5
Aktivitete të shërbimeve të tjera	1.2
Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	1.2
Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	0.7
Art, zbavitje dhe rekreacion	0.6
Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete rivitalizimi të tokës	-0.2
Akomodim dhe aktivitete te shërbimeve me ushqim	-4.1
Transport dhe ruajtje	-4.1

(Burimi: Banka Qendrore e Kosovës)

Investimet e jashtme direkte në Kosovë sipas shteteve (2022)

(Në milionë euro: deri më 31 dhjetor 2022)

Shteti	Vlera mil. €
Gjermania	194.2
Zvicra	155.2
ShBA	93
Shqipëria	79.8
Austria	44.7
Holanda	43.7
Turqia	39
Sllovenia	21.2
Kanada	17.8
Të tjera	89.5
TOTALI	778.2


(Burimi: Banka Qendrore e Kosovës)

Eksporti dhe Importi për vitin 2022 (Kosovë)

Me shifra

2022	
Eksport	920 405
Import	5 639 393
Bilanci tregtar	-4 718 989

Grafikon



(Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës)

Eksporti dhe Importi sipas vendeve fqinje për vitin 2022

(000 €)

Vendet	Eksporti		Importi	
	Vlera	%	Vlera	%
Shqipëria	101.962	11,1	255.862	4,5
Maqedonia	119.083	12,9	282.060	5,0
Serbia	62.896	6,8	372.065	6,6
Mali i zi	38.264	4,2	24.082	0,4
Bosna & Hercegovina	11.353	1,2	66.087	1,2
Zvicra	70.131	7,6	40.648	0,7
Turqia	23.455	2,5	842.998	14,9
27 vendet e BE-së	311.768	33,9	2.388.798	42,4
Partnerët tjerë	181.492	19,7	1.366.793	24,2
Gjithsej	920.405	100,0	5.639.393	100,0

(Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës)

Bilanci i energjisë në Kosovë për vitin 2022

Struktura e energjisë primare e konsumuar në Kosovë për vitin 2022 e përbëhet nga: thëngjilli, produktet e naftës (benzina, nafta, mazuti, kerozina dhe gazi i lëngëzuar i naftës-GLN), biomasa, hidroenergja, energjia e erës, energjia solare dhe biokarburantet. Energjia elektrike trajtohet si burim primar vetëm për sasinë e importit dhe eksportit. Kjo qasje është e bazuar në metodologjinë e EUROSTAT-it.

Konsumi final i energjisë

Të dhënat për sasinë e energjisë së konsumuar për vitin 2022 janë bazuar në hulumtimet e ndryshme që janë zhvilluar në Kosovë nëpër vite nga Institucione të ndryshme dhe te dhënave administrative të marruar nga institucionet e ndryshme lidhur me energjinë.


Konsumi i të gjitha produkteve energjetike në sektorin e amvisërisë

Konsumi i energjisë (i të gjitha produkteve energjetike), në sektorin e industrisë të vitit 2022 ka qenë 287,3 ktoe. Krahasuar me vitin 2021 kemi një rënie të lehtë prej 12,4%.

Produktet e naftës janë produktet më të konsumuara në sektorin e industrisë, me një sasi prej 61,1 %, pasuar nga energjia elektrike me 30,6%, thëngjilli 3,6%,biomasa 4,5% dhe të konsumit të përgjithshëm të energjisë në sektorin e industrisë

(Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës)

Struktura e energjisë elektrike në dispozicion sipas burimit të energjisë




(Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës)

STATISTIKA / GJERMANI

Bruto Produkti Vendor

Bruto Produkti Vendor në bazë të çmimeve aktuale / miliardë euro



(Burimi: Statistisches Bundesamt (Destatis))

Bruto Produkti Vendor në shifra

		Shifra të parregulluara				Shifra sipas çmimit X13 të rregulluar		
		Sipas çmimeve aktuale		Çmimi i rregulluar, i lidhur		të rregulluara në mënyrë sezonale dhe kalendarike		kalendar i rregulluar
		Miliardë EURO	% ¹	2015 = 100	% ¹	2015 = 100	% ²	% ^{1,3}
2022		3,869.90	7.4	107.79	1.8	107.60	1.9	1.9
2022	TM 1	941.09	9.2	107.52	4.1	107.59	1.0	3.8
	TM 2	949.83	8.2	106.46	1.7	107.46	-0.1	1.6
	TM 3	972.17	6.1	108.68	1.3	107.97	0.5	1.4
	TM 4	1,006.81	6.5	108.49	0.2	107.39	-0.5	0.8
2023	TM 1	997.86	6.0	107.34	-0.2	107.03	-0.3	-0.5

¹ Ndryshimi i vitit të kaluar ose i njëjti tremujor i vitit paraardhës në %

² Ndryshimi i vitit ose tremujorit të mëparshëm në %

³ Për sa i përket viteve, vlerat e rregulluara kalendarike janë të barabarta me atosezonale dhe ato të rregulluara kalendarike (me përjashtim të diferencave për shkak të rrumbullakimit).

⁴ TM - Tremujori

(Burimi: Statistisches Bundesamt (Destatis))

Ekonomia e Gjermanisë e krahasuar në nivel ndërkombëtar

Zhvillimi ekonomik i Gjermanisë, në fillim të vitit, ka mbetur prapa krahasuar në nivel ndërkombëtar. Performanca ekonomike në tremujorin e parë të vitit 2023 u rrit në shtetet e tjera të mëdha anëtare të Bashkimit Evropian (BE) dhe në BE në tërësi (+0.2%). Spanja dhe Italia shënuan rritjen më të madhe tremujore të Bruto Produktit Vendor, e rregulluar sipas çmimeve, sezonale dhe kalendarike (+0.5%), ndërkohë që Franca të paktën mund të raportonte një rritje të lehtë (+0.2%). Shtetet e Bashkuara (SHBA) gjithashtu përjetuan rritje të lehtë prej 0.3%.

Produkti i Brendshëm Bruto, çmimi, i rregulluar sezonalisht dhe kalendarik, tremujori i parë 2023. Ndryshimi në përqindje:

	ShBA	Eurozonë	BE27	Francë	Itali	Spanjë	Gjermani
Tremujori paraprak	0.3	0.1	0.2	0.2	0.5	0.5	-0.3
Tremujori i njëjtë i vitit të kaluar	1.6	1.3	1.2	0.8	1.8	3.8	-0.5

Tremujori paraprak: ndryshimi në tremujorin e katërt të 2022;

Tremujori i njëjtë i vitit të kaluar: ndryshim në tremujorin e parë të 2022;

(Burimi: Statistisches Bundesamt (Destatis))

ARSYET PËR TË INVESTUAR NË KOSOVË

Për kompanitë që kërkojnë të investojnë në një vend me shpenzime të vogla e me qasje të lehtë në BE, në Evropën Qendrore dhe në tregjet e Ballkanit, Kosova paraqet një mundësi shumë atraktive.

Në Kosovë, një investitor mund të regjistrojë biznesin për 2 ditë, falas me zero kapital çarter (për SHPK-të).

Regjimi i tregut të lirë

- Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) me Bashkimin Evropian (BE);
- Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me BE-në (mbi 500 milion konsumatorë);
- Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me Evropën Qendrore (CEFTA) (përfshinë 7 vendet jo-anëtare të BE-së: Shqipërinë, Bosnjë dhe Hercegovinën, Kosovën, Maqedoninë e Veriut, Moldavinë, Malin i Zi dhe Serbinë - popullsia: 21 milion);
- Programi i Sistemit të Gjeneralizuar të Preferencave (Generalized System of Preferences (GSP) Program) me SHBA-në, Japoninë dhe Norvegjinë.

Kosto e ulët e operimit

- Paga mesatare bruto në sektorin privat është 473 €;
- TVSH: 8% për produktet bazë (shërbimet dhe shporta e ushqimit) dhe 18% për produktet tjera;
- Tatimi në Dividendë: 0%
- Liberalizimi i Importit:
 - Linjat e prodhimit dhe pajisjet për prodhim
 - Lënda e parë për prodhim (që nuk prodhohet në Kosovë)
 - Pajisjet e teknologjisë informative (TI);
- Sistemi Elektronik i Prokurimit
- Tatimi në të Ardhurat e Korporatave: 10%
- Tatimi mbi të Ardhurat Personale: 0 - 10 % (progresive)
- Kontributi pensional i detyruar: 5%
- Kodi specifik tatimor për zhvlerësim
(Në bazë të nenit 15 të Ligjit për Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatës (nr.03/L- 162), shuma e lejuar për zbritje të zhvlerësimit për periudhën tatimore do të përcaktohet me aplikimin e përqindjeve të poshtëshënuara për llogaritë kapitale përmes metodës së balancimit të zbritjes:
 - Kategoria 1: Ndërtesat; pesë për qind (5%)
 - Kategoria 2: Automjetet dhe pajisjet për zyre; njëzet për qind (20%)
 - Kategoria 3: Makineritë dhe automjetet për transport të rëndë; pesëmbëdhjetë për qind (15%).

(Burimi: KIESA dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës)

Profili i anëtarëve

Shërbime	49.49 %
Ndërtimtari	36.03 %
Gastronomi	5.72 %
Tregti	2.69 %
Prodhim	2.02 %
Financa	2.02 %
Shëndetësi	1.35 %
Veshmbathje	0.67 %

Zotimi i bordit

“Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane do të jetë një urë e sigurt dhe një zë i fortë për anëtarët tanë, si në procesin e bashkëpunimit midis tyre, ashtu edhe në përfaqësimin e tyre në institucione, shoqata dhe kompani, në Gjermani dhe në vendet tona”.



ZYRA QENDRORE - GJERMANI

Tel. +49 (0) 211 88 250 220, +49 152 247 562 80
info@union-business.de, www.union-business.de

ZYRA NË PRISHTINË

Tel. +383 48 735 734



“Shkova sot në një intervistë dhe e fitova kontratën. Më thanë se do të filloja me 3000 dollarë në muaj dhe më pas, pas gjashtë muajsh, do të merrja 3500 dollarë në muaj. U thashë: në rregull, unë pra do t’ia filloj punës pas gjashtë muajsh”.



Paçi shëndet dhe suksese, në punë e në jetë!